

Fletë informative për azilkërkues në aeroport

Ju jeni arratisur dhe kërkoni mbrojtje në Zvicër? Ndiurma Zvicerane për Refugjatë SFH ka krijuar këtë fletë informative. Ajo ju shpjegon etapat më të rëndësishme të procedurës së azilit të kërkuar në aeroport.

Zyra zvicerane për ndihmesa ë refugjatëve SFH-ja është një organizatë joqeveritare e cila angazhohet për të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve. Faqen tonë të internetit e gjeni në adresën vijuese: www.fluechtlingshilfe.ch; informata për azilkërkues dhe refugjatë në shumë gjuhë i gjeni edhe këtu: www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe

1. Dorëzimi i kërkesës së azilit

1.1 Kërkesa e azilit në aeroport

Ju keni dorëzuar kërkesën e azilit në njërën prej aeroporteve të Zvicrës.

→ Gjatë kohës së procedurës (maksimalisht 60 ditë) banoni në zonën transitore të aeroportit në arealin e aeroportit. Vërejtje: Mund të shtroni ankesë kundër këtij vendimi.

→ Duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të identitetit dhe të udhëtimit. Do të merreni në pyetje.

1.2 Regjistrimi

Pasi që ju keni paraqitur kërkesë për azil, ju do të regjistroheni, fotografoheni dhe do ju merren shenjat e gishtërinjve. Organet zvicerane do e sqarojnë se a janë shenjat tuaja të gishtërinjve të regjistruara në bankën qendrore të te dhënave (Eurodac) përmes shteteve të Unionit Evropian, Norvegjisë, Lihtenshtajn apo Islandë. Nëse po, atëherë për mbajtjen e procedurës së azilit do të ishin kompetente këto shtete. Në këtë rast Zvicra do të tentonte të ju transferon në shtetin gjegjës. Ju keni të drejtë të paraqitni vetëm një herë kërkesë azili në ndonjë shtet të Unionit Evropian (Procedura DUBLIN). Vetëm shteti i parë i paraqitjes së azilit duhet të e pranon dhe përpunon atë. Nëse ju tani më keni paraqitur në një shtet tjetër evropian kërkesë për azil dhe ju jeni të mendimit që ky shtet nuk e ka trajtuar procedurën tuaj të azilit në mënyrë korrekte, atëherë kërkoni gjithsesi zyrën për këshillime juridike në aeroport. Kërkoni që ju të guxoni të mbeteni në Zvicër, pasi që ju si për shembull keni frikë, që ky shtet evropian, në të cilin Zvicra do të ju kthente prapa, do të ju transferon direkt në shtetin tuaj amë pa e shqyrtuar kërkesën tuaj të azilit. E njëjta vlen nëse në shtetin kompetent për shqyrtimin e kërkesës tuaj për azil keni frikë para trajtimeve me torturime, jonjerëzore dhe dënime poshtëruese.

1.3 Dëgjimi mbi të dhënat personale (biseda e parë)

Në kuadër të bisedës do të sqarohet, se a arsyetohet kërkesa juaj për azil sipas ligjeve zvicerane. Po që se nuk do të ishte kjo rasti juaj apo nëse ju e tërhiqni kërkesën, atëherë ky do të bie vendimi menjëherë (pa zyrtarizëm) dhe do të iniciohet kthimi juaj prapa.

Në aeroportin Zürich marrja e parë në pyetje bëhet nga policia e aeroportit. Në Aeroportin në Genf nga ana Sekretariatit Shtetërorë për Migrim (SEM).

Organet do ju pyesin juve mbi identitetin tuaj dhe mbi identitetin e familjes tuaj, mbi udhën që keni bërë deri këtu dhe arsyet e ikjes tuaj si dhe mbi shëndetin tuaj. Në këtë dëgjim merr pjesë një zyrtarë apo zyrtare dhe nëse e nevojshme një përkthyes apo përkthyes.

- Emëroni të gjitha arsyet e rëndësishme, se për se keni ikur nga vendi.
- Tregoni, se nëse keni përjetuar diçka, e nuk mund të e thoni para një burri apo gruaje, ashtu që të bëhet ekipi i dedikuar për dëgjim.
- Sqaroni arsyet nëse ju nuk keni dokumente identifikimi për dorëzim.
- Thoni se kur nuk keni kuptuar diçka.
- Tregoni për probleme shëndetësore, nëse keni të tilla. Atëherë eventualisht do të bëhet një kontroll mjekësorë.

Në fund të secili dëgjim ju duheni të e nënshkruani një protokoll. Kontrolloni saktësisht se a janë shënuar përgjigjet tuaja në mënyrë korrekte dhe se a janë shënuar të gjitha të dhënat, të cilat i keni bërë ju.



1.4 Dokumentet / provat

- Dokumentet që dëshmojnë situatën tuaj të përndjekjes jepini për t'u vendosur në dosje.
- Mbani fotokopje të të gjitha dokumenteve që dorëzoni.

1.5 Sqarimet

Eventualisht kryhen sqarime të mëtejshme në rastin tuaj.

- Në rast se ka dyshime lidhur me prejardhjen tuaj, mund të merreni në pyetje nga një njohës të gjuhëve dhe mund të kontrollohen njohuritë tuaja për vendin e prejardhjes suaj.
- Në rast se ka dyshime lidhur me moshën tuaj, mund të hartohet një ekspertizë.

1.6 Si do të vazhdojë?

- Ju merrni një letërnjoftim N (letërnjoftim për azilkërkues).
- Ju do të merreni në pyetje në mënyrë të hollësishme për shkaqet e juaj të azilit nga zyrtaret e Sekretariatit Shtetërorë për Migrim (SEM) dhe pastaj do të pranoni ose:
 - një vendim të mospranueshmërisë, kundër të cilit mund të shtroni një ankesë
 - një vendim negativ të azilit, kundër të cilit mund të shtroni një Ankesë
 - një aprovim për të hyrë në territorin e Zvicrës për ta vazhduar atje procedurën e azilit.

2. Intervista (biseda e dytë)

Intervistat në procedurën e azilit janë shumë të rëndësishme. Mund të intervistoheni një herë ose disa herë. Autoritetet gjykojnë kërkesën tuaj të azilit të mbështetur mbi intervistat dhe mbi protokollet e këtyre intervistave.

2.1 Kush merr pjesë në intervistat?

- Një nëpunës shteti ose një nëpunëse shteti e udhëheq intervistën.
- Një përkthyes ose një përkthyesë duhet të bëjë një përkthim të plotë, shpjegimet tuaja nuk duhet të vlerësohen ose të përfshihen. Personi përkthyes mund të mbetet anonim. Ju mund të shoqëroheni nga një përkthyes të cilin e zgjidhni ju, por ai vetë nuk duhet të jetë azilkërkuar.
- Një përfaqësues i një shoqate humanitare (HWV)-person që i përket një organizate joqeveritare- e vëzhgon procedurën. Ky person mund të kërkojë që të shtrohen pyetje të mëtejshme dhe do t'i dërgojë shoqatës së tij humanitare një raport për intervistën.
- Ju mund të shoqëroheni nga një përfaqësues ligjor të marrë në detyrë nga ju, ose nga ndonjë person madhor (ai vetë nuk duhet të ketë një kërkesë të papërfunduar azili).

2.2 Pyetjet

Në përgjithësi, rrjedha e një interviste është si vijon:

Pas prezantimit të të gjithë të pranishmëve, juve ju shpjegohet rrjedha e intervistës si dhe të drejtat dhe detyrat tuaja, pastaj nëpunësi ose nëpunësja e shtetit ju bën pyetje për situatën tuaj personale:

- për identitetin tuaj dhe për dokumente që dëshmojnë identitetin tuaj
- për familjen dhe të afërmit tuaj
- për shërbimin ushtarak
- për rrugën e udhëtimit nga vendi i nisjes deri në Zvicër
- për punësim në vendlindje dhe në Zvicër
- për qëndrimet jashtë vendit tuaj
- për përfaqësimin ligjor në vendlindje dhe në Zvicër

Pas kësaj keni mundësi për të shpjeguar përse kërkon mbrojtje në Zvicër.

Sipas ligjit (fragment nga neni 3 i Ligjit të Azilit), refugjatëve i jepet azil.

Refugjatë janë persona të cilët u janë nënshtruar disavantazheve serioze në vendlindjen e tyre ose në vendin në të cilin kanë banuar së fundi, për shkak të racës, fesë, kombësisë së tyre, përkatësisë së një grupi të përcaktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve të tyre politike, ose që kanë frikë të arsyetuar t'u nënshtrohen disavantazheve të tilla. Si disavantazhe serioze konsiderohen veçanërisht rrezikimi i shëndetit, i jetës ose i lirisë si dhe masa që shkaktojnë një shtypje të padurueshme psikike.

Duhet të merren parasysh arsyet e arratisë që janë specifike për femrat.

2.3 Parashtrimi i arsyeve të arratisë

Gjatë intervistës duhet të përshkruani të gjitha arsyet përse jeni arratisur dhe dëshironi të merrni azil. Ju mund të flisni lirisht dhe pa frikë. Të gjithë të pranishmit i nënshtrohen një të mbajtjes së fshehtësisë dhe nuk duhet t'i tregojnë askujt atë që thoni.

Kjo pjesë e intervistës është shumë e rëndësishme. Ju luteni të tregoni të gjitha se çfarë ose kush ju ka shtyrë ta braktisni vendlindjen tuaj.

- Përgjigjja juaj duhet të jetë e vërtetë. Tregoni sa më shumë hollësi.
- Bisedoni edhe për ndjenja, thuajeni nëse keni përjetuar ndonjë gjë për të cilën nuk mund të flisni para një burri ose para një gruaje.
- Sillni me vetë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me përndjekjen tuaj (thirrje në polici, gjykime, dokumente burgu, letra kërcënuese, dëshmi mjekësore, gazeta, fotografi e kështu me radhë - mbani kopjet me vete!).
- Nëse tashmë keni qenë në ndonjë shtet tjetër evropian dhe keni frikë se ky shtet do të ju dëbojë në vendlindjen tuaj ku ju kanoset rreziku nga torturat apo dënimet degraduese dhe jo njerëzore, e thoni këtë dhe e shtjelloni hollësisht frikën dhe shqetësimet e juaja.

Ndoshta ju shtrohen pyetje të mëtejshme për paqartësi, keqkuptime dhe kundërshtime.

2.4 Intervista e familjeve

Anëtarët e familjes merren në pyetje veçmas. Kur intervistohet një anëtar madhor i familjes, të tjerët duhet të presin në një dhomë tjetër. Po qe se nuk ka arsye kundër kësaj, fëmijët duhet të intervistohen në prani të prindërve të tyre.



2.5 Protokolli

Për çdo intervistë bëhet një protokoll. Pas çdo interviste ju përkthehet protokolli. Ju luteni të nënshkruani çdo faqe.

→ Thuajeni nëse ka diçka që nuk keni kuptuar. Verifikoni nëse protokolli përputhet saktësisht me atë që donit të thoshit. Kërkoni që të korrigjohen gabimet dhe paqartësitë.

Në fund të intervistës pyeteni se a keni edhe arsye të tjera, të papërmendura deri më tani, për qëndrimin në Zvicër. Duhet të konfirmoni me nënshkrimin tuaj se keni thënë gjithçka dhe që protokolli përputhet me të vërtetën.

3. Vendimet e azilit

Procedurat e azilit në aeroport zgjasin nganjëherë vetëm disa ditë ose javë.

Në qoftë se Sekretariati Shtetërorë për Migrim (SEM) nuk merr vendim të parë brenda 20 ditëve, ju mund të udhëtoni në një kanton. Qëndrimi i juaj në aeroport mund të zgjat më së shumti 60 ditë. Lidhni kontakt me kohë me qendrën këshilluese në aeroport (RBS). Kjo ju ofron juve këshillime procedurale dhe të shansit si dhe mbështetje tjera, nëse RBS e sheh si të domosdoshme.

Adresat e zyrave për këshillime juridike në aeroport

Zürich-Kloten

SRK, Sozial-, Rechtsberatung,
Transit ZH-Airport
Tel. 043 816 57 82, Fax 043 816 57 83

Elisa- asile

Case postale 542, 1214 Vernier
Tel. 022-733 37 57, Fax 022-930 00 49
E-Mail: info@elisa.ch

Adresat në kantone shiko nën:

<https://www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe>

Zakonisht merrni nga Sekretariati Shtetërorë për Migrim (SEM) një vendim me shkrim në gjermanisht, frëngjisht ose italisht.

Në procedurën e aeroportit ju mund të pranoni këto vendime vijuese:

3.1 Vendime pozitive

3.1.1 Miratimi për hyrje në Zvicër

Sekretariati shtetërorë ka vendosur se procedura e juaj e azilit do të zhvillohet në territorin e Zvicrës. Kjo nuk do të thotë se është një vendim definitiv mbi kërkesën e juaj të azilit, por është thjeshtë vetëm **një miratim për hyrje në Zvicër**.

3.2 Vendimet negative

3.2.1 Karakteristikat e refugjatit mohohen

Kërkesa e azilit refuzohet, dhe ju duhet të ikni nga Zvicra në fund të një afati largimi. Kjo është e mundur në qoftë se – sipas mendimit të autoriteteve – nuk keni arsye të mjaftueshme për pranim tuaj si refugjat ose në qoftë se nuk mund ta tregoni ose provoni historinë tuaj në mënyrë mjaft të besueshme.

3.2.2 Dublin - Vendimet

Nëse ju para hyrjes në Zvicër keni qenë në një shtet të Unionit Evropian (EU), në Islandë, Lihtenshtein apo Norvegji, kërkesa juaj, pas një dëgjimi të shkurtër (pa përfaqësues të organizatave bamirëse HWV) mbi udhëtimin tuaj, nuk do të shqyrtohet më në Zvicër porse në shtetin kompetent. Për këtë arsye ju duheni të ktheheni në këtë shtet.

3.2.3 Vendimi- Shteti i Tretë

Kërkesa juaj pas një dëgjimi të shkurtër nuk do të shqyrtohet më dhe ju duheni të e lëshoni Zvicrën menjëherë, atëherë kur ju para hyrjes në Zvicër keni qëndruar në një shtet tjetër apo kur ju keni vizë për një shtet tjetër.

3.2.4 Vendime tjera negative

Kërkesa juaj nuk shqyrtohet më tej, dhe ju duhet të largoheni menjëherë nga Zvicra, atëherë nëse

- Në qoftë se nuk kërkon mbrojtje në Zvicër, por keni ardhur vetëm e vetëm për arsye të tjera (probleme shëndetësore ose ekonomike)
- Ju keni lënduar obligimin tuaj të bashkëpunimit ashtu që keni fshehur identitetin tuaj të vërtetë (emri i gabuar, datëlindja e gabuar etj.) apo keni dhënë dëshmi të falsifikuara
- Në qoftë se shkelni detyrën tuaj për bashkëpunim me autoritetet zvicerane si për shembull duke mos ardhur në intervistë, apo nuk i keni qëndruar organeve në dispozicion më gjatë se 20 ditë
- Në qoftë se ju përsërisni vazhdimisht arsyet e paraqitjes së kërkesës dhe këtë e bëni disa herë.



4. Ankesa

Në qoftë se nuk jeni dakord me vendimin e azilit të Sekretariatit Shtetërorë për Migrim (SEM), mund t'i shkruani një ankesë Gjykatës Federale Administrative:

Bundesverwaltungsgericht

Postfach, CH-9023 St. Gallen

Telefon +41 (0)58 705 26 26

Faks +41 (0)58 705 29 80

Në procedurën e aeroportit ju i keni vetëm pesë ditë kohë nëse dëshironi të paraqitni një ankesë.

Qendra për këshillim ligjor (RBS) ose avokatë përkatësisht avokate, mund t'ju ndihmojnë. Listën e adresave të qendrës për këshillim ligjorë mund të e gjeni nën: <https://www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe>

Zyra zvicerane për ndihma të refugjatëve SFH juve ju vë në dispozicion edhe broshura informative dhe udhëzime për ankesa në 20 gjuhë të ndryshme nën: www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe/informationsblaetter

Ankesa duhet të përpilohet në njërën prej gjuhëve zyrtare (Gjermanisht, Frëngjisht apo Italisht). Ankesa duhet të jetë e nënshkruar në dy kopje dhe të dorëzohet me mjetet e pranishme të dëshmisë dhe me një kopje të vendimit. Bëni edhe për vete një kopje të vendimit dhe mbani atë.

Vini re: Nëse ju nuk paraqisni ankesë, si dhe pas refuzimit të ankesës, ju gjendeni ilegalisht në Zvicër.

Varësisht prej arsyes së refuzimit, pas pranimi të vendimit, ju mundeni të merreni në burgim.

Nëse ju paraqisni ankesë, normalisht ju mundeni të qëndroni në Zvicër deri sa të bie vendimi në lidhje me të. Mirëpo këtu bëhet një përjashtim: Kur ju keni marrë një vendim negativ sipas rregullores Dublin. Në këtë rast ju përkundër të gjithave ju mund të kërkonti, që vendimin mbi ankesë mund të e prisni në Zvicër. Mirëpo këtë ju duheni të e arsyetoni gjerësisht në lidhje me rastin tuaj konkret. Kërkonti me ngulm të qëndroni në Zvicër, nëse ju për shembull frikoheni se, ky shtet evropian kërkesën tuaj për azil nuk e merr në shqyrtim edhe pse ju i plotësoni karakteristikat e një refugjati dhe /apo ky shtet do të ju depërton në shtetin tuaj amë edhe pse atje juve ju kanoset torturimi apo dënime ose trajtime jonjerëzore dhe poshtëruese.

Edhe nëse ju do të transferoheni në këtë shtet evropian, mbi ankesën tuaj do të vendoset këtu në Zvicër. Nëse keni këtu një përfaqësues ligjorë, qëndroni me të në kontakt, edhe kur ju gjendeni jashtë vendit (Zvicrës). Pasi që vetëm në këtë mënyrë mund të ju kumtohen vendimet pozitive që ju mund të ktheheni prapa në Zvicër.

5. Informata të përgjithshme

Këshillim ligjor, avokat, avokate

Ju duhet të kujdeseni vetë për mbështetje juridike. Qendrat e këshillimit ligjor të shoqatave humanitare i gjeni nën

<https://www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe>

Ardhja e mëpasshme e familjes, ribashkim familjar

Azilkërkuesit nuk kanë të drejtën të marrin më pas anëtarë të familjes nga vendlindja.

Asistencë, ndihmë urgjente

Azilkërkuesit nevojtarë marrin asistencë gjatë procedurës së azilit.

Kushtetuta e Zvicrës (neni 12) u siguron të gjithë njerëzve që jetojnë në Zvicër, ndihmë dhe kujdesie në situata emergjente. Pas një vendimi negativ të azilit, keni të drejtën për ndihmë urgjente deri në largimin tuaj, edhe pse jeni ilegalisht në Zvicër. Kjo ndihmë përfshin: ushqim, strehim, veshmbathje dhe ndihmë mjekësore në raste urgjente. Meqë për këtë ndihmë urgjente duhet të lajmëroheni tek autoritetet, të cilat janë përgjegjëse edhe për dëbimin e juaj nga Zvicra, kaloni rrezikun që të arrestoheni. Informata të mëtejshme i gjeni në www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe

Punë

Autoritetet zvicerane u ndalojnë azilkërkuesve punën gjatë tre deri gjashtë muajt e parë. Pastaj mund të lejohet një punësim, ku vetëm pak degë janë të hapura, dhe punëtorëve vendas u jepet përparësi.

Banim

Duhet t'i njoftoni autoritetet menjëherë për çdo ndërrim adrese. Në përgjithësi, një ndërrim kantoni nuk është i mundur për azilkërkuesit.

Arrestim, burgim

Mund të arrestoheni në qoftë se:

- kërkesa e juaj e azilit është refuzuar me një vendim të mospranueshmërisë.
- refuzoni të bashkëpunoni me autoritetet
- kërkesa juaj e azilit vlerësohet si "keqpërdoruese".
- jeni bërë i penalizuar duke shkelur ligjin
- ka shenja konkrete se do t'i kundërshtoni dëbimit në vendlindjen tuaj.

Udhëtime jashtë shtetit

Nuk duhet të largoheni nga Zvicra gjatë procedurës së azilit dhe nuk duhet të hyni në kontakt me konsullatën ose me autoritetet e vendit nga keni ardhur.